

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 12.11.2024*

12.11.2024

Ora 15:47

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për miratimin e rregullave për procedurën e votimit nga jashtë
vendit” (vijon).

PJESËMARRJA :

KQZ:

• **Komisioni Rregullator:**

- | | | |
|------------|-----------|---|
| • Ilirjana | NANO | Kryetar |
| • Arens | ÇELA | Anëtar |
| • Dritan | ÇAKA | Anëtar |
| • Helga | VUKAJ | Anëtar |
| • Muharrem | ÇAKAJ | Anëtar |
| • Stafi | KQZ | Znj.J. Josifi, znj.P. Doçaj, znj.E. Demollari |
| Parti | Politike: | S’ka prezent |

OJQ:

KRIIK

Znj. I. Nano: Përshëndetje! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator, siç njoftuam dje, në orën 15.00, nisim pak me vonesë, pikërisht sepse u vlerësua që të kishim një konsultim lidhur me disa çështje të diskutueshme. Kemi votuar projektaktin në parim, kemi votuar kreun I, kreun II, kemi votuar kreun III, seksioni 1, 2. Jemi tek kreu III, seksioni 3 është lexuar dhe kolegu Çakaj kishte një propozim për të bërë një ndryshim në këtë seksion. Përpara se të shkojmë te propozimi i z.Çakaj, më duhet dhe njëherë të them që të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 12.11.2024*

janë të pranishëm, zyrtarë të administratës të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Zoti Çakaj!

Z. M.Çakaj: Faleminderit zonja Kryetare! Atëherë propozimi im konsiston në riformulimin e pikës 4 të kreut III.3, si më poshtë: “Zarfi i fletës së votimit i cili përmban vetëm fletën e votimit vendoset në zarfin e jashtëm të dërguar tek zgjedhësi nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve sipas parashikimeve të kreut III.1. Mbi këtë zarf KQZ do të vendosë/ngjisë kodin unik të regjistrimit të çdo zgjedhësi në PER. Kodi unik i zgjedhësit gjenerohet automatikisht nga PER dhe përmban emër, mbiemër të zgjedhësit, shtetin ku ka kërkuar t’i dërgohet fleta e votimit si dhe qarkun ku ka regjistrimin e Gjendjes Civile në Republikën e Shqipërisë. Kodi unik i zgjedhësit...

Znj. I. Nano: Regjistrin e Gjendjes Civile besoj?

Z. M. Çakaj: Po, Regjistrin e Gjendjes civile. “Kodi unik i zgjedhësit është gjithashtu i pasqyruar në formën në një bar kod ose QR kod. Pasi gjenerohet nga PER, kodi unik bëhet i disponueshëm për çdo zgjedhës nga jashtë vendit. Në momentin që zgjedhësit i mbërrin në adresën e deklaruar jashtë vendit zarfi i dërguar nga KQZ, zgjedhësi do të konfirmojë në PER marrjen në dorëzim të zarfit.” Pra, me pak fjalë merakun jonë si dhe merakun e administratës së KQZ-së besoj gjen adresim, së pari për uniformitet të të gjithë barkodeve, së dyti për thjeshtësi dhe shmangien e burokracisë për zgjedhësin nga jashtë, është propozuar që kodin unik ta printojë KQZ dhe ta ngjisë në çdo zarf që i dërgohet zgjedhësit nga jashtë dhe zgjedhësi e konfirmon në momentin që i mbërrin zarfi në adresën e deklaruar e konfirmon në

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 12.11.2024*

PER. Mënyrën se si e konfirmon është i lirë ta eksplorojë Komisioni Qndror i Zgjedhjeve. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Çakaj! Atëherë votojmë propozimin e kolegut për ndryshimin e pikës 4, të seksionit 3, të kreut III.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Atëherë votojmë në tërësi kreun III.

Kush është dakord, kolegë?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Me 5 vota pro miratohet!

Kalojmë në kreun III, seksioni 4, “Ruajtja dhe administrimi i dokumentacionit zgjedhor të dërguar nga zgjedhësi nga momenti i mbërritjes në territorin e Republikës së Shqipërisë deri në fillimin e numërimit dhe vlerësimit të votave nga jashtë”. 1. “Operatori i shërbimit postar, i cili administron brenda vendit dokumentacionin zgjedhor të dërguar nga zgjedhësi nga jashtë e të mbërritur në territorin e Republikës së Shqipërisë i administron dërgesat në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi si dhe me aktet për votimin nga jashtë të miratuar nga KQZ. 2. Operatori i shërbimit postar ka detyrimin që pritja, grumbullimi dhe ruajtja

**Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 12.11.2024*

e dokumentacionit zgjedhor nga momenti i mbërritjes në Republikën e Shqipërisë deri në dërgimin e këtij dokumentacioni në KQZ duhet të bëhet në një ambient të posaçëm i cili duhet të ketë shërbim të monitorimit me kamera. Regjistrimet e këtij monitorimi ruhen në përputhje me parashikimet ligjore përkatëse, por në çdo rast deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve. 3. Operatori i shërbimit postar shënon në një regjistër të posaçëm të gjithë të dhënat mbi dërgesat e dokumentacionit zgjedhor si të tilla, por jo vetëm, emër dhe mbiemër të dërguesit, shtetin si dhe datën dhe orën e mbërritjes. 4. Partitë politike të cilat kanë përfaqësues të përhershëm në KQZ kanë të drejtë të caktojnë mbikqyrës të ambientit të operatorit të shërbimit postar ku ruhet dhe administrohet dokumentacioni zgjedhor i dërguar nga zgjedhësi. 5. Operatori i shërbimit postar ka detyrimin e dorëzimit në KQZ të dokumentacionit zgjedhor brenda 24 orëve, me këtë rast midis KQZ-së dhe operatorit të shërbimit postar mbahet një procesverbal. Dorëzimi mund të bëhet në ambientet e KQZ-së ose në ato të operatorit të shërbimit postar. 6. KQZ ruan dhe administron dokumentacionin zgjedhor të marrë në dorëzim nga operatorit i shërbimit postar në një ambient të veçantë, i cili monitorohet me kamera. Partitë politike të cilat kanë përfaqësues të përhershëm në KQZ kanë të drejtë të caktojnë mbikqyrës, monitorues të ambientit ku KQZ ruan, administron dokumentacionin zgjedhor. Ambienti në fjalë mund të vëzhgohet pa asnjë kufizim edhe nga vëzhgues të tjerë të regjistruar në KQZ. 7. Pasi ka marrë në dorëzim zarfin e shërbimit postar KQZ e hap atë dhe lexon të dhënat e kodit unik që përmban zarfi që gjendet brenda zarfit të shërbimit postar. Këto të dhëna shënohen në një regjistër të posaçëm, në këtë regjistër shënohet edhe ora e regjistrimit të këtyre të dhënave në regjistrin e posaçëm. Menjëherë pas regjistrimit në këtë regjistër njofton zgjedhësin në llogarinë e tij në PER se vota e tij u administrua në KQZ dhe se do të vlerësohet në afatin e përcaktuar në Kodin Zgjedhor. 9. Zarfi që përmban kodin unik bashkëlidhet me

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 12.11.2024*

zarfin e shërbimit postar dhe futet në një kuti plastike të posaçme, e cila nga këtu e në vijim do të përkufizohet si kutia e votimit nga jashtë. Kutia e votimit nga jashtë është e ngjashme në funksionalitet me kutinë e votimit që përdoret për votimin në qendrën e votimit. 10. Dokumentacioni zgjedhor i zgjedhësve nga jashtë depozitohet në kutinë e votimit nga jashtë veçmas për çdo qark. Kutia e votimit nga jashtë është e tejdukshme nga të paktën 4 anët e saj. Kjo kuti duhet të mbyllet me kapak i cili lidhet me kutinë me jo më pak se katër vula me kode sigurie. Kapaku duhet të ketë një të çarë nëpërmjet së cilës mund të futet dokumentacioni zgjedhor i ardhur nga jashtë, por njëkohësisht kjo e çarë nuk duhet të lejojë nxjerrjen e këtij dokumentacioni. E çara në kapakun në kutinë e votimit nga jashtë duhet të mundësojë funksionalitetin e mbylljes me vulë, me kod sigurie. 12. Përpara depozitimit të dokumentacionit zgjedhor në kutinë e votimit nga jashtë mbyllja e saj me kapakun përkatës bëhet nga KQZ publikisht në prani të përfaqësuesve të partive politike, të medias dhe të organizatave të shoqërisë civile që vëzhgojnë procesin zgjedhor. KQZ shënon në një procesverbal kodet e vulave të sigurisë me të cilën mbyllet çdo kuti e votimit nga jashtë. Partitë politike si dhe vëzhgues mund të marrin një kopje të këtij procesverbal. 13. Dokumentacioni zgjedhor i mbërritur, i cili është depozituar në kutinë përkatëse të votimit nga jashtë ruhet në këtë kuti deri në fillimin e procedurave përkatëse të numërimit për qarkun përkatës. 14. Nëse pas hapjes së zarfit të shërbimit postar rezulton se mungon zarfi që përmban kodin unik të zgjedhësit ose në zarfin që duhet të ishte vendosur/ ngjitur kodi unik mungon ky i fundit apo në tërësi dokumentacioni zgjedhor nuk është në përputhje me parashikimet e seksionit 3 të këtij akti, të këtij vendimi, atëherë KQZ mban një procesverbal. Në këtë rast dokumentacioni zgjedhor i këtij zgjedhësi vendoset në një kuti të posaçme të votimit nga jashtë. 15. Në përfundim të procesit të votimit brenda vendit KQZ në prani të përfaqësuesve të partive politike dhe të vëzhguesve mbyll

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 12.11.2024*

kutinë e votimit nga jashtë si dhe kutinë e posaçme, duke shënuar në procesverbal kodin e vulës së sigurisë me të cilën mbyllet kutia përkatëse si dhe numrin e zgjedhësve, dokumentacioni zgjedhor i të cilëve është depozituar respektivisht në to. 16. Nëse shërbimi postar depoziton në KQZ dokumentacion zgjedhor të zgjedhësve nga jashtë pas mbylljes së kutisë së votimit nga jashtë, atëherë KQZ e regjistron këtë dokumentacion sipas rregullave të përcaktuara në këtë kre dhe e depoziton dokumentacionin zgjedhor në një kuti votimi nga jashtë rezervë të qarkut përkatës. Nëse janë në kushtet e pikës 14 të këtij kreu atëherë KQZ e depoziton dokumentacionin përkatës zgjedhor në kutinë e posaçme rezervë të votimit nga jashtë.” Atëherë lexova seksionin 4 të kreut III, fillojmë me diskutimet. Zonja Vukaj!

Znj. H. Vukaj: Për sa lexuat në draft kemi ndërhyrjet tona edhe pas konsultimit që bëmë me administratën për elementin apo mendësinë e realizimit konkret të këtij procesi apo risqet e mundshme, apo procedurat konkrete si do të integrohet i gjithi në tërësi. Me këtë rast, për t’i dhënë më siguri procesit kam ndërhyrjet e mia në pothuajse një pjesë dërrmuese të pikave të këtij kreu. Nis me pikën 2, ku në fund të pikës 2 më duhet të shtoj dhe të propozoj fjalinë e re: “Me kërkesë të subjekteve zgjedhore u vihet në dispozicion një kopje e regjistrimeve të këtij monitorimi, me argumentin që subjektet zgjedhore për sa kohë në të gjithë, kanë akses në të gjithë materialet e regjistruara, që me një kërkesë mund t’i marrin në çdo kohë edhe në këtë rast duhet të kenë aksesin përmes realizimit formal të një kërkesë adresuar KQZ-së. Pra ky është propozimi i parë. Të vazhdoj me propozimet e tjera apo të shikojmë pikë pas pike?”

Znj. I. Nano: Po.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 12.11.2024*

Znj. H. Vukaj: Dakord.

Znj. I. Nano: T'i kalojmë një nga një? Dakord. Pra, në pikën 2 të kreut III.4 shtohet fjalia “Me kërkesë subjekteve zgjedhore u vihet në dispozicion një kopje e regjistrimeve të këtij monitorimi”.

Znj. H. Vukaj: “Me kërkesë të subjekteve zgjedhore u vihet në dispozicion një kopje e regjistrimeve të këtij monitorimi”.

Znj. I. Nano: Pra dhe njëherë “Me kërkesë të subjekteve zgjedhore u vihet në dispozicion një kopje e regjistrimeve të këtij monitorimi”, votojmë këtë propozim kolegë?

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Kalojmë te propozimi i radhës.

Znj. H. Vukaj: Do votojmë dhe pikën 1?

Znj. I. Nano: Votojmë propozimet dhe pastaj votojmë në tërësi krejt seksionin.

Znj. H. Vukaj: Dakord. Me pikën 1 jemi dakord, kështu siç është në tekst. Në pikën 5 “Operatori i shërbimit postar ka detyrimin e dorëzimit në KQZ të dokumentacionit

**Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 12.11.2024*

zgjedhor”, afati këtu është 24 orë por ne propozojmë të bëhet një afat periodik, të paktën dy herë në 24 orë. Atëherë propozimi duhet të jetë “Operatori i shërbimit postar ka detyrimin e dorëzimit në KQZ të dokumentacionit zgjedhor, të paktën dy herë brenda 24 orëve. Me këtë rast midis KQZ-së dhe operatorit të shërbimit postar mbahet një procesverbal marrje në dorëzim të materialit zgjedhor” dhe pjesa tjetër pastaj të hiqet, “Dorëzimi të bëhet në ambientet e KQZ-së”, po.

Znj. I. Nano: Pra, “Operatori i shërbimit postar ka detyrimin e dorëzimit në KQZ të dokumentacionit zgjedhor, të paktën dy herë brenda 24 orëve.

Znj. H. Vukaj: “Dorëzimi të bëhet në ambientet e KQZ-së”.

Znj. I. Nano: Me këtë rast midis KQZ-së dhe operatorit të shërbimit postar mbahet një procesverbal marrje në dorëzim të materialit zgjedhor”, fjali tjetër mbetet siç ishte.

Znj. H. Vukaj: Fjalja tjetër...


Znj. I. Nano: “Dorëzimi të bëhet në ambientet e KQZ-së”.

Z. M. Çakaj: Jo se ka “dhe/ose”.

Znj. I. Nano: “ose në atë të operatorit të shërbimit postar”, pra në këtë rast propozimi juaj të bëhet “vetëm në ambientet e KQZ-së”?

Z. M. Çakaj: Shiko mund ta sqarojë administrata, presumohet që...

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 12.11.2024*

Znj. J. Josifi: Jo thjesht për sqarim, dëgjova me vëmendje propozimin, domethënë preket fjalia e parë e pikës 5 sepse duhet të paktën dy herë brenda 24 orëve, çdo 24 orë. Fjalia e dytë qëndron.

Znj. I. Nano: Mbahet një procesverbal.

Znj. J. Josifi: Ndërkohë fjalia e tretë mbyllet në “dorëzimi bëhet në ambientet e KQZ-së” apo jo?

Z. M. Çakaj: Është e mundur teknikisht kjo?

Znj. J. Josifi: Po patjetër.

Z. M. Çakaj: Sepse prezumohet që operatori i shërbimit postar ka një ambient të vetin, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka një ambient të tijin. Pra, të bëjmë diferencën ambienti i operatorit të shërbimit postar, me ambientin e KQZ-së, nëse është e mundur teknikisht.

Znj. J. Josifi: Patjetër, si teknikalitet për t’u vendosur më vonë se mundej që stafi ynë të shkonte dhe ta tërhiqte nga ambientet e operatorit.

Z. M. Çakaj: Gjithsesi ai...

Znj. H. Vukaj: Gjithsesi në një ambient do të përfundojë.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 12.11.2024*

Z. M. Çakaj: Gjithsesi nëse ai ambient, qoftë i operatorit të shërbimit postar do të vihej në dispozicion të KQZ-së konsiderohet ambient i KQZ-së. Dakord.

Znj. I. Nano: Mendoj që është tjetër gjë, ai është ambienti ku operatori i shërbimit postar ka postën e vet, po e quaj se s'jam as e saktë me terminologjinë. Pra, ka një mënyrë dorëzimi ose posta vjen e sjell në KQZ ose KQZ-ja shkon e merr te ambienti i shërbimit postar.

Znj. H. Vukaj: Duhet të vijë ta sjellë në KQZ, është më e pranueshme sepse ngjall më shumë besim.

Znj. I. Nano: Dakord. Atëherë votojmë propozimin 1, kemi propozimin për dorëzimin të paktën dy herë brenda 24 orëve, kemi “mbahet një proceverbal marrje në dorëzim të materialit zgjedhor” dhe te fjalia e fundit “Dorëzimi do të bëhet në ambientet e KQZ-së”.

Kush është dakord, kolegë?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Znj. H. Vukaj: Viojmë me pikën 6 ku do lexoj fjalinë ashtu siç është dhe më pas do të bëj shtesat në këtë fjali. Paragrafin e parë konkretisht: “KQZ ruan dhe administron dokumentacionin zgjedhor të marrë në dorëzim nga operatori i shërbimit postar në një ambient të veçantë” dhe unë po shtoj “të sigurt dhe të paaksesueshëm nga persona të paautorizuar”, “i cili monitorohet me kamera”. Pra ky ambienti

**Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 12.11.2024*

monitorohet me kamera është ideja. “Regjistrimet e kamerave ruhen dhe një kopje e tyre i vihet dispozicion me kërkesë çdo subjekti zgjedhor”.

Znj. I. Nano: Lidhur me fjalinë e fundit “Ambienti në fjalë mund të vëzhgohet pa asnjë kufizim edhe nga vëzhgues të tjerë të regjistruar në KQZ”, keni ndonjë propozim? Atëherë propozimi i znj. Vukaj.

Znj. H. Vukaj: Ta vijoj meqë kishim këtë konfondimin në dy draftet e ardhura. Atëherë meqenëse kjo është inkorporuar, në këtë pikë është inkorporuar një shtesë që ka qenë në një pikë tjetër, vijoj t’i mbetem propozimit të ardhur zyrtarisht së fundmi: “Ambienti në fjalë mund të vëzhgohet pa asnjë kufizim edhe nga vëzhgues të tjerë të regjistruar në KQZ”.

Znj. I. Nano: Pra kjo fjali mbetet. Atëherë “KQZ ruan dhe administron dokumentacionin zgjedhor të marrë në dorëzim nga operatori i shërbimit postar në një ambient të veçantë, të sigurt dhe të paaksesueshëm nga persona të paautorizuar i cili monitorohet me kamera. Regjistrimet e kamerave ruhen dhe një kopje e tyre i vihet dispozicion me kërkesë çdo subjekti zgjedhor. Ambienti në fjalë mund të vëzhgohet pa asnjë kufizim edhe nga vëzhgues të tjerë të regjistruar në KQZ”. Votojmë këtë propozim. Atëherë zonja Vukaj diçka tjetër?

Znj. H. Vukaj: Shiko kemi këtë konfondimin e drafteve në fakt edhe duhet qartësuar dhe njëherë kjo pikë.

Znj. I. Nano: Dy minuta atëherë. Atëherë zonja Vukaj dhe njëherë propozimin tuaj.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 12.11.2024*

Znj. H. Vukaj: Edhe njëherë propozimi pasi vlerësuam draftin e ardhur zyrtarisht. Pika 6, të vijojë me fjalinë, domethënë të ndërpritet deri në momentin ku thuhet “i cili monitorohet me kamera”, më pas të vazhdojë fjalia, kjo të jetë fjalia e parë. Fjalia e dytë të jetë “Partitë politike të cilat kanë përfaqësues të përhershëm në KQZ kanë të drejtë të caktojnë mbikqyrës ose monitorues të ambientit ku KQZ ruan/administron dokumentacionin zgjedhor. Ambienti në fjalë mund të vëzhgohet pa asnjë kufizim edhe nga vëzhgues të tjerë të regjistruar në KQZ” dhe ajo që unë propozova më lart të spostohet si fjali e fundit duke qenë “Regjistrimet e kamerave ruhen dhe një kopje e tyre i vihet në dispozicion me kërkesë çdo subjekti zgjedhor.”

Znj. I. Nano: Votojmë pikën 6 sipas propozimit të znj. Vukaj.

Kush është dakord, kolegë?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s’ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Kemi më tej?

Znj. H. Vukaj: Viojmë pikën 7, po e lexoj dhe në të njëjtën kohë aty po implementoj dhe fjalitë rregulluese apo fjalët që propozoj në kuadër të rifomulimit. “Pasi ka marrë në dorëzim zarfin e shërbimit postar, KQZ e hap atë, e lexon fillimisht të dhënat e kodit unik që përmban zarfi që gjendet brenda zarfit të shërbimit postar. Këto të dhëna shënohen në një regjistër të posaçëm elektronik. Në këtë regjistër shënohet ora dhe data e regjistrimit të këtyre të dhënave.” Kjo të jetë pika 7.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 12.11.2024*

Znj. J. Josifi: Keni parashikuar...

Znj. H. Vukaj: Pikërisht pra, në këtë kuadër të këtij propozimi dhe qëndrueshmërisë së tij ju duket më fleksibël, në praktikitet pasja e një regjistri elektronik apo fizik, si e keni menduar realizimin?

Znj. J. Josifi: Ne iu përmbajtëm parashikimit të Kodit, pra regjistër që mund të ishte edhe elektronik por edhe fizik, patjetër që regjistri elektronik për ne në momentin që kemi një kod unik i cili është edhe në formën e një barkodi ose QR kodi, sipas parashikimeve pika më lart e kemi shumë të thjeshtë ta implementojmë regjistrin elektronik.

Znj. H. Vukaj: Apo për hir të...

Znj. J. Josifi: Mund t'i mbajmë të dy format...

Znj. H. Vukaj: Atëherë e lëmë të lirë, regjistër të posaçëm, në kllapa vendosim pastaj fizik/elektronik. Dakord?

Znj. J. Josifi: Po, patjetër!

Znj. I. Nano: I posaçm patjetër.

Znj. H. Vukaj: I posaçëm është por specifikimi është që t'i çeli dritë, që përveç regjistrin fizik të kenë edhe regjistrin elektronik të mbajtjes së të dhënave. Kështu që

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 12.11.2024*

në kllapa unë propozoj të jetë regjistri i zakonshëm fizik/elektronik, ose të dy bashkë.
Kështu që kaq kisha për pikën 7.

Znj. I. Nano: Atëherë pika 7 “Pasi ka marrë në dorëzim zarfin e shërbimit postar KQZ e hap atë dhe lexon fillimisht të dhënat e kodit unik që përmban zarfi që gjendet brenda zarfit të shërbimit postar. Këto të dhëna shënohen në një regjistër të posaçëm (fizik/elektronik), në këtë regjistër shënohet dhe ora e regjistrimit të këtyre të dhënave.” Ta votojmë këtë pikë kolegë?

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s’ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Kemi diçka tjetër?

Z. M. Çakaj: Po.

Znj. I. Nano: Po zoti Çakaj!

Z. M. Çakaj: Atëherë në pikën 8 propozoj të riformulohet, po ju jap dhe arsye si më poshtë, “Menjëherë pas regjistrimit në këtë regjistër KQZ njofton zgjedhësin në llogarinë e tij në PER se zarfi me materialet zgjedhore u administrua në KQZ dhe se do të vlerësohet në afatin e përcaktuar në Kodin Zgjedhor”, propozimi fillestar i administratës, i Komisionerit ishte “vota”, duke qenë se vota në moment që mbërrin në KQZ është e futur në zarf e vogël dhe normalisht është e palexueshme në atë

**Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 12.11.2024*

moment, ne nuk mund ta dimë në atë moment nëse ka në zarfin e vogël votë apo jo, kështu që termi i duhur do të ishte “zarfi me materialet zgjedhore” i mbërritur.

Znj. I. Nano: Votojmë propozimin e kolegut për ndryshimin e pikës 8.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s’ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Kalojmë te pika 9, unë kam një pyetje. Pika 9 thotë “Zarfi që përmban kodin unik bashkëlidhet me zarfin e shërbimit postar dhe futet në një kuti plastike të posaçme, e cila nga këtu e në vijim do të përkufizohet si kutia e votimit nga jashtë. Kutia e votimit nga jashtë është e ngjashme në funksionalitet me kutinë e votimit që përdoret për votimin në qendrën e votimit”, e para pse do ta quajmë e posaçme, se më pas kemi në projektakt një kuti të posaçme, e dyta thuhet që, nga sa diskutuam dje kemi tre zarfa, zarfi që përmban fletën e votimit, zarfin e votimit nga jashtë ku është kodi unik dhe zarfin e shërbimit postar. Pra ne e kemi hapur zarfin e shërbimit postar dhe pastaj do të bashkëlidhim zarfin e shërbimit postar me zarfin...

Znj. J. Josifi: Pra ideja është që ky zarfi nuk hidhet që në këtë moment.

Znj. I. Nano: I shërbimit postar?

Znj. J. Josifi: Zarfi i shërbimit postar pra nuk hidhet, nuk asgjesohet, nuk humbet, ruhen ashtu, ky seti mbetet i plotë

**Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 12.11.2024*

Znj. I. Nano: Dhe pastaj në momentin e administrimit do të, në aktin e radhës, dakord.

Znj. J. Josifi: Por ky zarfi i shërbimit postar u hap për arsye që të skanohet kodi unik, pra që të regjistrohet në regjistrin e posaçëm. Nuk hidhet, pra nuk zhduket, nuk humbet.

Znj. H. Vukaj: Po në vijim të pyetjes së koleges, domethënë i mëshoj faktit “kuti plastike të posaçme”, pra është...

Znj. J. Josifi: Nuk lidhet me kuti votimi nga jashtë.

Znj. H. Vukaj: Mos ndoshta duhet “kutia plastike përkatëse”?

Znj. J. Josifi: Po pra ruhet në një...

Znj. H. Vukaj: A e kishit kështu idenë?


Znj. J. Josifi: Pra është ideja për të mos thënë është kutia e votimit nga jashtë.

Znj. I. Nano: Nga këtu e në vijim thoni “është kuti e votimit nga jashtë”?

Znj. J. Josifi: Po, pra është dhënë sqarimi që bëhet fjalë për një kuti, kjo është kutia e votimit nga jashtë, nëse është përsëritje, pra nuk është një kuti tjetër, më kuptoni?

Znj. I. Nano: Mua më konfondon me kutinë e veçantë dhe kur themi...

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 12.11.2024*

Znj. J. Josifi: Jo.

Znj. I. Nano: ...kutia e votimit nga jashtë, të paktën me sa e lexojmë aktin do të kemi 12 të tilla, prandaj kutia përkatëse do ishte më mirë, të votimit nga jashtë “dhe futet në kutinë përkatëse të votimit nga jashtë”.

Znj. J. Josifi: Në kutinë përkatëse në kuptimin e zonës zgjedhore përkatëse.

Znj. H. Vukaj: Përkatëse ka përfshirë të gjithë detajet me të cilat lidhet kutia.

Znj. J. Josifi: Pra është kutia e votimit nga jashtë kjo nuk është një kuti tjetër.

Znj. I. Nano: Po pra po vetëm të krijojmë idenë që tani që po e lexojmë, po e miratojmë nga kush na dëgjon, që do kemi 12 të tilla.

Znj. J. Josifi: Do të kemi 12 kuti votimi nga jashtë.

Znj. I. Nano: Pra kur thua kutia, duket sikur kemi vetëm një të tillë. Nëse themi në “kutinë përkatëse”.

Znj. J. Josifi: E kemi në pikën 10 sqarimin që dokumentacioni depozitohet në kutinë e votimit nga jashtë veçmas për çdo qark. Pra del në këtë pikën pasardhëse fakti që kemi 12 kuti.

Znj. I. Nano: Po pra, po duket sikur kemi një kuti në fillim. Pra kolegë si mendoni futet në kutinë përkatëse të votimit nga jashtë dhe më tej sqarohet te pika 10?

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 12.11.2024*

Z. M. Çakaj: Po sikur ta integronim pikën...

Znj. I. Nano: Nëntën me dhjetën?

Z. M. Çakaj: Tetën me nëntën është më mirë.

Znj. I. Nano: Nëntën me dhjetën është...

Znj. J. Josifi: Nëntën me dhjetën në projektvendimin e propozuar.

Z. M. Çakaj: Atëherë “Zarfi që përmban kodin unik bashkëlidhet me zarfin e shërbimit postar dhe futet në kutitë e votimit nga jashtë veçmas për çdo qark, të cilat nga këtu e në vijim”, kjo s’ka nevojë “te kutitë e votimit nga jashtë, janë të ngjashme në funksionalitet me kutitë e votimit që përdoren për qendrën e votimit”. Pra e integrojmë 9 dhe 10 nëse na shkon.

Znj. J. Josifi: Ndoshta zarfi që përmban kodin unik bashkëlidhet me zarfin e shërbimit postar dhe futet në kutinë e votimit nga jashtë, për çdo qark” duhet thënë.

Znj. H. Vukaj: Qartësia...

Znj. I. Nano: “Kutinë përkatëse të votimit nga jashtë, e cila është e ngjashme në funksionalitet me kutinë e votimit që përdoret për votimin në qendrën e votimit”. Edhe pikën 10 e shtojmë si fjali tek pika 9 “Dokumentacioni i zgjedhësve që depozitohet nga jashtë veçmas për qark.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 12.11.2024*

Z. M. Çakaj: Diçka për qartësi, është e ngjashmevetëm në funksionalitet se në përmasa besoj?

Znj. J. Josifi: Prandaj kemi thënë vetëm në funksionalitet, por ajo pastaj është akt më vete, përcaktimi i karakteristikave.

Z. M. Çakaj: I bie të jetë, paraprakisht ne i bie ta kemi një ide sepse ta kemi me hamendësim është ajo se jo domosdoshmërisht lista përfundimtare e zgjedhësve për çdo qark do të jetë e...

Znj. J. Josifi: Volumin maksimal do ta dimë këtë të paktën 60 ditë para datës së zgjedhjeve, të dimë numrin e saktë maksimal që presim.

Z. M. Çakaj: Qartë.

Znj. I. Nano: Atëherë ishte vetëm që të jetë fjalinë e fundit më mirë e lëmë pika 10 dhe thjesht themi “futet në kutinë përkatëse të votimit nga jashtë, kutia e votimit nga jashtë është e ngjashme në funksionalitet me kutinë e votimit që përdoret për votimin në qendër të votimit”. Pra vetëm “kutinë përkatëse”, të heqim të posaçme.

Kush është dakord, kolegë?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s’ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Kemi propozime të tjera për pikën 10, 11, 12 e me radhë?

**Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 12.11.2024*

Znj. H. Vukaj: Pika 12, një saktësim në fjalinë e fundit të kësaj pike, të zëvendësohet “partitë politike” me “subjektet zgjedhore”, si dhe “vëzhgues kanë të drejtë të marrin kopje të këtij procesverbali”.

Znj. I. Nano: Pra jo fjala “mund” po “kanë të drejtë”.

Znj. H. Vukaj: “Kanë të drejtë”, jo fjala “mund”.

Znj. I. Nano: Dakord. Kalojmë në votim ju lutem.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s’ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Më tej kemi propozime të tjera për këtë pikë? Nuk kemi propozime të tjera, janë miratuar deri tani disa propozime kështu që më duhet të kaloj në votimin në tërësi të, meqenëse pësoi disa ndryshime. Votimi në tërësi të kreut III, seksioni 4. Kolegë dhe njëherë dakordësinë tuaj.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s’ka!

Miratohet me 5 vota pro!

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 12.11.2024*

Kalojmë në kreun IV “Monitorimi dhe mbikqyrja e procesit” veçmas, posaçërisht parashikohet në këtë vendim përfaqësuesit e partive politike, organizatat e shoqërisë civile të të angazhuara në fushat e të drejtave të njeriut ose zgjedhjeve, media apo palë të tjera me interes të ligjshëm në këtë proces kanë të drejtë të mbikqyrin çdo aspekt të proceseve të rregulluara nga ky vendim”. Kush është dakord? Po, keni ndërhyrje?

Z. M. Çakaj: Më fal, kisha një riformulim, thjesht për qartësi të kësaj pike. Atëherë propozoj të riformulohet kjo pikë si më poshtë: “Me qëllim integritetin dhe garantimin e votës nga jashtë vendit, përfaqësuesit e partive politike, organizatat e shoqërisë civile të angazhuara në fushën e të drejtave të njeriut dhe/ose zgjedhjeve, media apo palë të tjera me interes të ligjshëm në këtë proces kanë të drejtën të mbikqyrin çdo aspekt, në çdo kohë dhe në çdo fazë të proceseve të rregulluara nga ky vendim dhe akte të tjera të KQZ”.

Znj. I. Nano: Kalojmë në votimin e propozimit, kush është dakord kolegë me kreun IV?

Kush është dakord, kolegë?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s’ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Kreu V “Dispozita të fundit”, “Ngarkohet administrata e KQZ-së dhe institucionet e ngarkuara me detyra nga ky vendim me zbatimin e tij. 2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të

**Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 12.11.2024*

Zgjedhjeve. 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë brenda 5 ditëve nga shpallja e këtij vendimi”. Po zoti Çakaj!

Z. M. Çakaj: Atëherë, meqë dhe në herën e kaluar vendosëm një standard, atëherë pika 1 të riformulohet: “Ngarkohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i cili përfshin dhe Komisionerin dhe administratën, si dhe institucionet e ngarkuara me detyra nga ky vendim me zbatimin e tij.”

Znj. I. Nano: Dakord. “Ngarkohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe institucionet e ngarkuara me detyra nga ky vendim me zbatimin e tij”. Atëherë votojmë kreun V?

Kush është dakord, kolegë?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s’ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Kalojmë në votimin në tërësi të projektvendimit, i cili ka pësuar gjatë shqyrtimeve, diskutimit disa ndryshime.

Kush është dakord, kolegë?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s’ka!

Miratohet me 5 vota pro!

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 12.11.2024*

Ne nuk kemi çështje tjetër në rendin e ditës për të diskutuar sot. Kemi pasur dy mbledhje ditëve, dje dhe sot për këtë projektakt, ka pësuar disa ndryshime, do t'ju lutesha që ditën e nesërme të mundësoni zbardhjen, ta kalojmë për ta parë.

Znj. H. Vukaj: Dhe ai shqetësimi permanent që duam të dimë se ku është, në ç'fazë është akti tjetër sipas matricës, një apo dy aktet e mbetura apo më shumë akte sipas propozimeve që do të bëjë Komisioneri.

Znj. J. Josifi: Besoj që brenda dy ditëve do të kemi aktin për numërimin, vëzhgimin në numërim, vlerësimin e votave, pra aktin e fundit sa i përket aspekteve procedurale të procesit. Ndërkohë që akti tjetër deklarativ, ne matricën e akteve nuk kishim një afat për të që dhe Kodi nuk na kishte lënë një afat përfundimtar. Kemi menduar që atë akt ta sjellim në një moment të dytë, pra pasi të kemi krijuar të gjitha kushtet teknike dhe jo vetëm rregullatore dhe të përcjellim për shqyrtimin tuaj atë aktin për përfshirjen për herë të parë të procedurave të votimit nga jashtë vendit në procedurat e zakonshme të votimit, parashikuar në nenin 24.

Z. M. Çakaj: Atëherë ju deklaruat që brenda dy ditëve do të kemi këtë akt, pra normalisht i bie në datën 14 nëntor, besoj jeni në dijeni të afatit që ka parashikuar Kodi Zgjedhor që afati ligjor për miratimin e gjithë këtyre akteve është 90 ditë dhe në mos gaboju ky afat është në datën 15 nëntor, 13 jo është nesër apo në datë 15 në mos gaboju kur ka hyrë në fuqi afati ligjor maksimal, i bie 13.

Znj. J. Josifi: I bie 13 nëntor, jemi të vetëdijshëm që jemi në përfundim të afatit, po kronologjia e tillë e akteve.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 12.11.2024*

Z. M. Çakaj: Po procesi të konsultimit publik do t'i nënshtrohet ky akt?

Znj. J. Josifi: Patjetër që po, po besoj që duke qenë një akt i cili lidhet me procedura administrative të institucionit do të lëmë një kohë ndoshta më të shkurtër të jemi dhe brenda afateve, po patjetër do të konsultohet dhe do t'ju dërgohet juve menjëherë sapo t'i dërgohet, pra do t'ju dërgohet njëherë ju ashtu sikundër dhe gjithë palëve për konsultim publik përpara thirrjes së për vënien në lëvizje të Komisionit Rregullator.

Znj. I. Nano: Faleminderit znj. Josifi! Faleminderit, mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Vendimi nr.13

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*

